

Vuaj nga një sëmundje reumatizmi :

si të vendosi për ose
kundër një vakisonimi
kundër COVID-19

Disa mundësi për të
menduar mirë...



A. Kam një sëmundje reumatizmi që tani për tani nuk kërkon një trajtim imuniteti - immunosuppresseur

1. Cilat janë rreziqet e komplikimeve nëse infektohem me koronavirus ?

Sëmundjet e reumatizmit ose auto-inflamacionet nuk i paraprijnë një sëmundje COVID-19 të rëndë. Rreziqet varen nga mosha juaj (ato rriten progresisht nga mosha 55 vjeç) ose nga prania e faktorëve të rreziqeve (hipertensioni, peshë e tepërt, etj).

2. Cilat do të ishin për mua përfitimet dhe rreziqet gjatë vaksonimit kundër COVID-19 ?

Rreziqet e efekteve dytësore janë të njëjta sikur te personat tjerë të moshës suaj : një reagim inflamacioni gjatë 1-3 ditëve dhe shumë rradhë një reagim alergjik. Deri më sot, nuk ekziston asnjë dyshim që vaksonimi rrezikon ta rëndoj gjendjen e sëmundjes tuaj.

Përfitimet e vaksonimit janë të rëndësishme nëse ju keni nevojë në të ardhmen për një trajtim të imunitetit – immunosuppresseur. Në të vërtetë, sistemi juaj imunitar do të zhvillojë përgjigje më të mira duke përfshirë një imunitet të qëndrueshëm memorie i aftë tu përgjigjet përsëritjeve gjatë disa viteve.

B. Vuaj nga një sëmundje reumatizmi dhe marr një trajtim imuniteti - immunosuppresseur :

1. Rrezikoj nga COVID-19 dhe a duhet të vaksinohem edhe pse jam i ri (më pak se 40 vjeç) ?

Trajtimet immunosuppresseurs ju bëjnë më të ndieshëm nga të gjitha viruset – përfshi edhe atë të COVID-19. Ata rrisin rreziqet që virusi mos të eliminohet shpejtë me rrezikun e komplikimit dhe ngjitjes së virusit të afërmëve tuaj. Nëse jeni në trajtim immunosuppresseur, ky është është një tregues që ju duhet të vaksinoheni kundër COVID-19.

2. ***Mund ta marrë një vaksinë ? Cilën do qoftë nga vaksinat që gjenden në Zvicër ? Trajtim im ose sëmundja ime, do ta zvogëlojnë efikasitetin e vaksinave/njërës nga vaksinat ?***

Këshilla ime është që të përfitoni nga vaksinat ARN messenger (Pfizer ose Moderna) që janë më efikase për të përfituar një mbrojtje më të mirë të mundshme. Në të vërtetë, sëmundja juaj nuk do ta zvogëlonte efikasitetin e vaksinave, por kjo mund të zvogëlohet nga trajtimi mjekësor që ndiqni në varësi të llojit të trajtimit dhe dozave që keni nevojë.

3. ***A rrezikoj të kem efekte dytësore ? Cilat ? Të rënda ?***

As sëmundja juaj, as trajtimi juaj nuk rrisin rreziqet për efekte dytësore. Në të vërtetë, vaksinat ARN messenger nuk janë vakcina të gjalla ; ato nuk mund të shumëzohen, ato nuk mund të shkaktojnë COVID-19, ato janë aq të brishta sa që eliminohen për disa ditë. Nëse ju merrni një trajtim kundër inflamacionit, është e mundur që reagimi ndaj inflamacionit që vërehet shpesh pas vaksinimit të bëjë që ai të zvogëlohet ; kjo nuk do të thotë që vakcina nuk do të jetë efikase.

C. Vuaj nga polyarthrite rhumatoide i trajtuar me méthotrexate, medikament që zvogëlon mbrojtjen time imunitare

1. ***Vaksina, a mund të favorizojë shfaqjen e një sëmundje tjetër auto-imune ?***


Jo, asnjë shenjë nuk e thotë. Fija e vogël e kodit ARN messenger është aq e brishtë – përkundër mbrojtjes së saj nga një pikë e imtë vaji – sa që eliminohet për 2-3 ditë. Aktivizimi i sistemit imunitar i nxitur nga vaksinimi është më i dobët dhe më i shkurtër se çdo infeksion tjetër viral (rhume, gastro...)

Në të kundërtën, COVID-19 mundet nganjëherë të shkaktojë një sëmundje auto-imune, pa dyshim tek personat me një terren gjenetik paradispozues.

Pra, nëse vuani nga një sëmundje auto-imune, kjo është një arsye më shumë ta mbron trupin tuaj nga kjo sëmundje. .

2. **Po dëgjoj të flitet për vaksinën ARN. Mund ta ndryshojë kjo kodin tim gjenetik dhe të ketë pasoja afatgjate për shëndetin tim (kancer ?), për fëmijët e mi që do të lindin ?**

Jeni të sigurtë ! ARN messenger i vaksinave është një kod për proteinën e sipërfaqes së koronavirusit. Ai « përbihet » nga celulat që e kthejnë proteinën në pjesën e jashtme (cytoplasme). Në asnjë moment ARN messenger nuk hyn në bërthamën e qelizës, aty ku ndodhen gjenet tona. Pra, ai nuk mund të vendoset dhe të rrezikojë të shkaktojë efekte dytësore të gjata.



Burimi : www.infovac.ch

3. **Sa kohë qëndron vakcina në trupin tim ?**

Jo më shumë se disa ditë (2-3 ditë në llojin e kafshëve ku kjo është studiuar)

4. **A janë efikase kundër variantit/eve të virusit (varianti anglez) të gjitha vaksinat në Zvicër ?**

Po. Ky variant shumë ngjitës nuk e zvogëlon efikasitetin e vaksinave ARN messenger (Pfizer ose Moderna).

C. Vuaj nga spondylarthritis ankylosante dhe marr një bio-terapi që zvogëlon mbrojtjet e mia imunitare

1. *Kam vuajtur nga COVID-19 për Kërshendella (Noël), a duhet të vaksionohem ? Nëse po, kur ?*

Sa më i rëndë që të jetë COVID-19, mbrojtja imunitare do të jetë më e madhe. E dijmë që mbrojtja pas infektimit zgjat më së paku 3 muaj. Pra, vaksionimi rekomandohet 3 muaj pasi që e keni kaluar sëmundjen COVID-19.

Me rëndësi : nuk ka rrezik për tu vaksionuar nëse e keni COVID-19 pa e ditur. Nuk është e nevojshme të bëni një serologji para vaksionimit.

2. *Në të kaluarën e kam evituar të vaksionohem kundër gripit sepse kam pasur, ka disa vite, të rrahura të forta zemre dhe zbehje pa e humbur vetëdijen. Mund ta marrë megjithatë vaksinën ? Vaksinat e ndryshme kundër COVID-19 janë të ndryshme ndaj rrezikut për alergji ?*

Të rrahurat dhe zbehja pas një vaksine janë reagime tipike që shkaktohen nga stresi, një ndryshim i shpejtë i pozicionit të ulurit, etj. Nuk ka shenja për reagim alergjic. Përbërësit e vaksinës kundër gripit janë më të shumtë dhe më të ndryshëm se këta të vaksinës ARN messenger. Pra, ju mund ta merrni pa frikë. Personat që kanë pasur alergji të rënda munden gjithashtu të vaksionohen, por me një kujdes të veçantë për të cilin janë në njohuri qendrat e vaksionimit.

D. Vajza ime 14 vjeç vuan nga « arthrite juvénile idiopathique » dhe merr një trajtim që e zvogëlon mbrojtjen e imunitetit.

1. *A mund të vaksionohet ajo përkundër moshës së saj ?*

Kjo nuk këshillohet... sepse studimet klinike që provojnë tolerancën tek të rinjtë adoloshentë janë në zhvillim e sipër. Vaksinat nuk janë të regjistruara para moshës 16 vjeç (Pfizer) dhe 18 vjeç (Moderna). Për ndryshe, përvoja e viti 2020 ka treguar që trajtimi i COVID-19 në përgjithësi ka qenë i lehtë tek fëmijët dhe adoloshentët me një trajtim immunosuppresseur.

2. *Ne prindërit e saj, a duhet dhe a mundemi të vaksionohemi me përparësi për të zvogëluar rrezikun që ta infektojmë atë ?*

Ju mund të vendosni lirisht të vaksionoheni apo jo në funksion të mbrojtjes që dëshironi për ju. Në të vërtetë, vajza juaj nuk paraqet rrezik të lartë për një COVID-19 të rëndë... për më tepër që shokët e shoqet saja nuk jnaë vaksionuar !

Për të ditur më shumë rreth vaksinave kundër COVID-19 :

<https://www.infovac.ch/fr/les-vaccins/par-maladie/coronavirus-covid-19>

Për ta verifikuar nëse jeni të mbrojtur si ju dëshironi nga vaksinat, përfitoni nga aplikacioni mjekësor i integruar në librezën e vaksionimit elektronik zvicran : <https://www.mesvaccins.ch/login.html>

Profesor Claire-Anne Siegrist
Shefe e qendrës së vaksionimit HUG

Infirmerja specialiste e Ligës është në dispozicionin tuaj për t'ju informuar, të ju ndihmojë të gjeni zgjidhje për të përmisuar cilësinë e jetës suaj.

Ekipi ynë do të jetë i lumtur të ju presi në lokalet tona

Mos hezitoni të na kontaktoni.



Ligue genevoise contre le rhumatisme (LGR)

Rue Merle d'Aubigné 22
1207 Genève

Téléphone 0041 22 718 35 55

Fax 0041 22 718 35 50

Orari i hapjes :

Hënë – Martë – Enjte : 14h00 në 17h00

Mërkurë – Premte: 8h30 në 12h00 dhe prej 14h00 në 17h00

www.laligue.ch

E-mail laligue@laligue.ch

Dëshironi ta mbështesni

**la Ligue genevoise contre le rhumatisme
(LGR),**

bëhuni anëtar mbështetës,

CHF 40.00 në vit

Iban CH97 0900 0000 1200 4967 4

**Kontributi juaj është në
duar të sigurta.**



**Votre don en
bonnes mains.**